



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:043099

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05295252

KPPP.nr. 1822/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit të kundërpërmbartimit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë, nr. 36, “City Computer” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. “Ilaz Kodra”, nr. 1-C, duke vendosur sipas propozimit për kundërpërmbartim të paraqitur me datë 28.01.2016, jashtë seancës, me datë 07.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit të kundërpërmbartimit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë dhe debitorit të kundërpërmbartimit “City Computer” Sh.P.K., me seli në Prishtinë.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Kreditori Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me datë 28.01.2016, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë ka paraqitur propozim për kundërpërmbartim ndaj debitorit “City Computer” Sh.P.K., me seli në Prishtinë për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej EUR 93,493.87.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar sipas propozimit për kundërpërbarim, me Aktvendimin CP.nr. 3063/16, të datës 24.02.2023, është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore për procedimin e kësaj çështje, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës.

Dhomat e Shkallës së Parë pranë Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbare më është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbare më, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbare më, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbare më (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbare më, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa”*.

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbare më sipas propozimit për kundërpërbarim të kreditorit të kundërpërmbare më Korporata Energjetike e Kosovës, ndaj debitorit të kundërpërmbare më “City Computer” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbare më të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbare më.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbare më është caktimi dhe zbatimi i përmbare më nga gjykata si organ përmbare më sipas propozimit për kundërpërbarim të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata

Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1822/23, datë 07.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.